

PROCESVERBAL- TIPI I KONTRATËS - SHËRBIME

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E TERMAVE TE REFERENCES DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: Trajnime profesionale për stafin e AGS sh.a

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 79632000-3;

VLERA E FONDIT LIMIT: 2,770,000 (dy milion e shtatëqind e shtatëdhjetë mijë) lekë pa tvsh;
Loti 1: Trajnime mbi kërkesat e direktivës ATEX (Direktiva 2014/34/EU) dhe standardet përkatëse
SSH EN 60079-14:2024 ose ekuivalente me fond limit 2,600,000 (dy milion e gjashtëqind mijë)
lekë pa tvsh;

Loti 2: “Trajnime në fushën e menaxhimit të cilësisë” me fond limit 170,000 (njëqind e
shtatëdhjetë mijë) lekë pa tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2,
pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të
prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Albanian Gas Service Company SH.A**
ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e termave të referencës dhe kriterëve
për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT **Loti 1:**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenet 76, 82 “Formulari
permbledhes i vetdeklarimit”, në nenin 83 ”Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për
Prokurimin Publik” të ndryshuar, si dhe në nenin 30/1, te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për
Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, të ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të
paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për tre vitet e fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën

një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të fondit limit të lotit perkatës, apo shumatores së fondit limit të të dy loteve për të cilat oferton.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3 të LPP i ndryshuar, si dhe nenin 43, pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës është bërë brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe paraqitja e një dëshmie të lëshuar nga administrata tatimore vërteton besueshmërinë dhe kapacitetet financiare që ka një operator ekonomik ofertues nëpërmjet xhiros të realizuar në një nga këto tre vitet e fundit. Është e rëndësishme që ofertuesi para se të dorëzojë ofertën të kuptojë dhe të vlerësojë aftësitë/mundësitë e tij që lidhen me kapitalin e nevojshëm për ekzekutimin me sukses të një kontrate të kësaj përmase që AK po prokuron.

2.2 Aftësitë teknike:

2.2.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës të fondit limit të lotit perkatës, apo shumatores së fondit limit të të dy loteve për të cilat oferton.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën që AK kërkon të realizojë, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenet e sipërcituara.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet në vlerën prej

20% të fondit limit, në afat dhe me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme është një elementë thelbësor ndaj operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore për ta provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën ose autorizimin e vlefshëm, të lëshuar nga autoriteti përkatës, si Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) ose një institucion ekuivalent, me Kodin X.2.B, në të cilën të jetë i specifikuar qartë, në shtojcën përkatëse, titulli i kursit të trajnimit ATEX.

Argumentimi: Vendosja e këtij kriteri bazohet në nenin 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Ky kriter vendoset me qëllim garantimin e aftësisë profesionale dhe ligjore të operatorëve ekonomikë për ofrimin e shërbimeve të trajnimit, duke siguruar që këto shërbime të kryhen vetëm nga subjekte të licencuara/autorizuara nga institucionet kompetente. Kjo kërkesë është në përputhje edhe me parimin e proporcionalitetit, të parashikuara në ligjin për prokurimin publik. Duke qenë se shërbimi i trajnimit kërkon kompetencë të posaçme dhe përbushje të standardeve teknike dhe profesionale, vlerësohet e domosdoshme që operatorët ekonomikë të disponojnë dokumentacionin përkatës të licencimit, në funksion të garantimit të cilësisë së shërbimit.

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të disponojë në stafin e vet të paktën një trajnues të kualifikuar për zhvillimin e trajnimit, i cili duhet të provojë kualifikimet dhe eksperiencën përkatëse nëpërmjet dokumentacionit si më poshtë:

- CV e detajuar të trajnuesit/ve ku të përfshihen minimalisht eksperiencën në trajnime profesionale teknike në instalimet elektrike në atmosfera shpërthyese (ATEX); eksperiencën në zbatimin e standardeve EN 60079-14:2024 ose ekuivalente dhe IEC EN 60079-17:2023 ose ekuivalente;

Këto kualifikime mund të mbulohen nga një ose më shumë persona.

Për përbushjen e kriterit, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e trajnuesit/ve të kualifikuar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas Shtojcës 10 të DT. Ndërsa dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga OE i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit paraprak të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit sipas percaktimeve të nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Argumentimi: Vendosja e këtij kriteri bazohet në nenin 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Kërkesa që operatori ekonomik të disponojë në stafin e tij të paktën një trajner të kualifikuar për zhvillimin e trajnimit vendoset me qëllim garantimin e kapacitetit profesional dhe teknik të nevojshëm për realizimin me sukses të shërbimit objekt prokurimi. Duke qenë se trajnimi lidhet

me fusha të specializuara dhe me risk të lartë teknik, si instalimet elektrike në atmosfera shpërthyes (ATEX), është thelbësore që ai të realizohet nga persona me eksperiencë të provuar dhe njohuri të thelluara në këtë fushë. Kërkesa për paraqitjen e CV-së së detajuar të trajnerit, ku të pasqyrohen minimalisht eksperiencia në trajnime profesionale teknike në instalimet elektrike në atmosfera shpërthyes (ATEX), si dhe eksperiencia në zbatimin e standardeve EN 60079-14:2024 ose ekuivalente dhe IEC EN 60079-17:2023 ose ekuivalente, shërben për të verifikuar realisht aftësitë profesionale dhe eksperiencën praktike të trajnerit të propozuar.

Kjo siguron që trajnimi të mos jetë vetëm teorik, por i mbështetur në njohuri dhe eksperiencë konkrete në zbatim të standardeve ndërkombëtare. Ky kriter është i nevojshëm për të garantuar cilësinë e shërbimit të trajnimit, transferimin efektiv të njohurive tek pjesëmarrësit dhe përputhshmërinë me kërkesat teknike të fushës ATEX, e cila kërkon nivel të lartë ekspertize dhe përgjegjshmërie profesionale. Gjithashtu, kriteri është në përputhje me parimin e proporcionalitetit, transparencës dhe trajtimit të barabartë, pasi nuk kufizon konkurrencën në mënyrë të pajustificuar, por siguron që operatorët ekonomikë të kenë kapacitetet minimale të nevojshme për realizimin e kontratës në standardet e kërkuara. Në këtë mënyrë, kërkesa synon të minimizojë riskun e realizimit të trajnimeve nga persona të pakualifikuar dhe të garantojë një shërbim profesional, të sigurt dhe në përputhje me standardet teknike ndërkombëtare në fuqi.

2.2.4 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se duhet të paraqesë një program të detajuar të trajnimit, nese do të shpallet fitues, i cili duhet të përfshijë përmbajtjen e plotë të temave që do të trajtohen, objektivat e trajnimit, metodologjinë e zhvillimit, kohëzgjatjen dhe strukturën e trajnimit.

Argumentimi: Vendosja e këtij kriteri bazohet në nenin 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Kërkesa për paraqitjen e një programi të detajuar trajnimi vendoset me qëllim garantimin e cilësisë së shërbimit të trajnimit që do të ofrohet, si dhe për të siguruar që përmbajtja e trajnimit të jetë e plotë, e strukturuar dhe në përputhje me objektivat e përcaktuara në Termat e referencës.

Ky dokument i detajuar i trajnimit mundëson vlerësimin e saktë të metodologjisë së propozuar, përmbajtjes së moduleve, kohëzgjatjes dhe mënyrës së zhvillimit të trajnimit, duke garantuar që shërbimi i ofruar të jetë profesional, i standardizuar dhe i përshtatshëm për nevojat e autoritetit kontraktor.

Gjithashtu, ky kriter është në përputhje me parimet e ligjit për prokurimin publik, veçanërisht me parimin e transparencës dhe proporcionalitetit. Në këtë mënyrë, kërkesa garanton që trajnimi të mos jetë i përgjithshëm apo formal, por të përfaqësojë një program real, të detajuar dhe të orientuar drejt rezultateve konkrete të të nxënësve dhe synon realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.2.5 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se do zbatojë rregullat e përcaktuara në Kodin e Etikës të AGS SH.A lidhur me realizimin e objektit të kësaj kontrate. (Ky kod është i publikuar në SPE se bashku me DT).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 41/6 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar ku parashikohet se: Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

AGS SH.A është një shoqëri shërbimesh operative, përgjegjëse për kryerjen e veprimtarisë së mirëmbajtjes dhe shërbimeve teknike për Trans Adriatic Pipeline AG sipas Marrëveshjes së Mirëmbajtjes midis Trans Adriatic Pipeline AG dhe AGSco. Ndaj AGSco në marrëdhëniet me biznesin, bazohet dhe ndjek parimet e besnikërisë, korrektësisë, transparencës, efikasitetit dhe tregut të lire, parime këto të përcaktuara jo vetëm në legjislacionin e prokurimit por edhe në Kodin e Etikës të shoqërisë. Në këtë Kod janë përcaktuar edhe rregullat mbi (praktikat korruptive, favoritët e paligjshme, marrëveshjet e fshehta dhe kërkesat për përfitime personale për veten ose të tjerët etj.), që grupet e interesit (përfshirë ofertuesit) duhet t’i vlerësojnë nëse ato kërkojnë të bashkëpunojnë me AGS SH.A, prandaj përpara se operatorët ekonomikë të ofertojnë duhet të njihen dhe marrin përsipër t’i zbatojnë këto rregulla. Për më tepër, argumentojmë se këto rregulla nuk bien ndesh me rregullat e prokurimit publik, prandaj është vlerësuar nga ana jonë edhe vendosja e kriterit se operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë se do zbatojë rregullat e përcaktuara në Kodin e Etikës të AGS SHA që kanë lidhje me realizimin e objektit të kësaj kontrate.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT Loti 2:

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurimin e Ofertës, *sipas Shtojcës 3;*

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, *sipas shtojcës 10.*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenet 76, 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, në nenin 83 ”Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar, si dhe në nenin 30/1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, të ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për tre vitet e fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të fondit limit të lotit përkatës, apo shumatores së fondit limit të të dy loteve për të cilat oferton.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3 të LPP i ndryshuar, si dhe nenin 43, pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës është bërë brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe paraqitja e një dëshmie të lëshuar nga administrata tatimore vërteton besueshmërinë dhe kapacitetet financiare që ka një operator ekonomik ofertues nëpërmjet xhiros të realizuar në një nga këto tre vitet e fundit. Është e rëndësishme që ofertuesi para se të dorëzojë ofertën të kuptojë dhe të vlerësojë aftësitë/mundësitë e tij që lidhen me kapitalin e nevojshëm për ekzekutimin me sukses të një kontrate të kësaj përmase që AK po prokuron.

2.3 Aftësitë teknike:

2.2.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës të fondit limit të lotit përkatës, apo shumatores së fondit limit të të dy loteve për të cilat oferton.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën që

AK kërkon të realizojë, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituara.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet në vlerën prej 20% të fondit limit, në afat dhe me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme është një element thelbësor ndaj operatorët ekonomikë duhet të

paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore për ta provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme të kategorisë X.2.B, të lëshuar nga autoriteti kompetent (QKB ose institucion ekuivalent), në shtojcën e së cilës të jetë i përfshirë kursi “Auditimi i Sistemeve të Menaxhimit” ose kurse/trajtime ekuivalente në fushën e sistemeve të menaxhimit të cilësisë.

Argumentimi: Vendosja e këtij kriteri bazohet në nenin 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Ky kriter vendoset me qëllim garantimin e aftësisë profesionale dhe ligjore të operatorëve ekonomikë për ofrimin e shërbimeve të trajnimit, duke siguruar që këto shërbime të kryhen vetëm nga subjekte të licencuara/autorizuara nga institucionet kompetente. Kjo kërkesë është në përputhje edhe me parimin e proporcionalitetit, të parashikuara në ligjin për prokurimin publik dhe e lidhur ngushtësisht me objektin e prokurimit. Duke qenë se shërbimi i trajnimit kërkon kompetencë të posaçme dhe përbushje të standardeve teknike dhe profesionale, vlerësohet e domosdoshme që operatorët ekonomikë të disponojnë dokumentacionin përkatës të licencimit, në funksion të garantimit të cilësisë së shërbimit.

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatë akreditimi të lëshuar nga DPA si organizëm që operon në fushën e certifikimit të personelit në përputhje me kërkesat e standardeve ISO/IEC 17024:2012 ose ISO/IEC 17021-1-2015.

Argumentimi: Vendosja e këtij kriteri bazohet në nenin 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Kërkesa për paraqitjen e certifikatës së akreditimit të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit për operim në fushën e certifikimit të personelit në përputhje me standardet ISO/IEC 17024:2012 ose ISO/IEC 17021-1-2015, vendoset me qëllim garantimin që operatori ekonomik të ketë kapacitetin institucional dhe njohjen zyrtare për kryerjen e shërbimeve të certifikimit të njohura ndërkombëtarisht.

Ky kriter siguron që procesi i certifikimit të pjesëmarrësve në trajnim të kryhet nga një organ i akredituar dhe kompetent, duke garantuar besueshmërinë, paanshmërinë dhe vlefshmërinë ndërkombëtare të certifikatave të lëshuara. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në fushën e trajnimeve teknike dhe profesionale, ku njohja e certifikatës dhe përputhshmëria me standardet ndërkombëtare përbëjnë një element thelbësor të cilësisë së shërbimit.

Gjithashtu, kërkesa është në përputhje me parimet e ligjit për prokurimin publik, veçanërisht me parimin e proporcionalitetit dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë, pasi nuk kufizon konkurrencën në mënyrë të pajustificuar, por vendos një standard minimal të domosdoshëm për sigurimin e cilësisë së shërbimit si dhe realizmin me sukses të kontratës.

2.2.4 Operatori ekonomik duhet të disponojë në stafin e vet të paktën një trajnues të kualifikuar për zhvillimin e trajnimit, i cili duhet të provojë kualifikimet dhe eksperiencën përkatëse nëpërmjet dokumentacionit si më poshtë:

- CV e detajuar të trajnuesit/ve ku të përfshihen minimalisht eksperiencia në zhvillimin e trajnimeve në fushën e standardeve ISO; eksperiencia në ofrimin e trajnimeve për auditimin e sistemeve të menaxhimit;
 - Certifikate përkatëse të vlefshme të trainuesi në kualifikime ndërkombëtare (si NEBOSH, IOSH ose ekuivalente me to), të lëshuara nga institucione të njohura ndërkombëtare;
 - Certifikate përkatëse të vlefshme të trainuesit si Lead Auditor.
- Këto kualifikime mund të mbulohen nga një ose më shumë persona.

Për përmbushjen e kriterit, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e trajnuesit/ve të të kualifikuar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas Shtojces 10 të DT. Ndërsa dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga OE i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit paraprak të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit sipas percaktimeve të nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Argumentimi: Vendorsja e këtij kriteri bazohet në nenin 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Kërkesa që operatori ekonomik të disponojë në stafin e tij të paktën një ose më shumë trajnerë të kualifikuar për zhvillimin e trajnimit vendoset me qëllim garantimin e kapacitetit profesional, teknik dhe metodologjik të nevojshëm për realizimin cilësor të shërbimit objekt prokurimi. Duke qenë se trajnimi lidhet me fushën e standardeve ndërkombëtare të menaxhimit dhe auditimit të sistemeve, është e domosdoshme që ai të realizohet nga trajnerë me eksperiencë të provuar dhe kualifikime të njohura ndërkombëtarisht.

Kërkesa për paraqitjen e CV-së së detajuar të trajnerit ose trajnerëve, ku të pasqyrohet eksperiencia në zhvillimin e trajnimeve në fushën e standardeve ISO dhe në ofrimin e trajnimeve për auditimin e sistemeve të menaxhimit, shërben për verifikimin e eksperiencës praktike dhe aftësive profesionale në fushën përkatëse. Kjo siguron që trajnimi të jetë i strukturuar, profesional dhe i bazuar në praktikën më të mira ndërkombëtare.

Gjithashtu, kërkesa për posedimin e certifikatave të vlefshme ndërkombëtare (si NEBOSH, IOSH ose ekuivalente) dhe certifikata si Lead Auditor synon të garantojë që trajnerët zotërojnë njohuri të avancuara dhe të certifikuara në fushën e sigurisë, menaxhimit dhe auditimit të sistemeve, duke rritur besueshmërinë dhe cilësinë e trajnimit të ofruar.

Ky kriter është në përputhje me parimet themelore të prokurimit publik, veçanërisht me parimin e proporcionalitetit, transparencës dhe trajtimit të barabartë, pasi nuk synon të kufizojë konkurrencën, por të sigurojë një nivel minimal të domosdoshëm profesional dhe teknik për realizimin e kontratës.

Në këtë mënyrë, kriteri garanton që shërbimi i trajnimit të ofrohet nga persona të kualifikuar dhe të certifikuar ndërkombëtarisht, duke siguruar realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.2.5 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se do zbatojë rregullat e percaktuara në Kodin e Etikës të AGS SH.A lidhur me realizimin e objektit të kësaj kontrate. (Ky kod është i publikuar në SPE së bashku me DT).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 41/6 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar ku parashikohet se: Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

AGS SH.A është një shoqëri shërbimesh operative, përgjegjëse për kryerjen e veprimtarisë së mirëmbajtjes dhe shërbimeve teknike për Trans Adriatic Pipeline AG sipas Marrëveshjes së Mirëmbajtjes midis Trans Adriatic Pipeline AG dhe AGSco. Ndaj AGSco në marrëdhëniet me biznesin, bazohet dhe ndjek parimet e besnikërisë, korrektësisë, transparencës, efikasitetit dhe tregut të lire, parime këto të përcaktuara jo vetëm në legjislacionin e prokurimit por edhe në Kodin e Etikës të shoqërisë. Në këtë Kod janë përcaktuar edhe rregullat mbi (praktikat korruptive, favorët e paligjshme, marrëveshjet e fshehta dhe kërkesat për përfitime personale për veten ose të tjerët etj.), që grupet e interesit (përfshirë ofertuesit) duhet t’i vlerësojnë nëse ato kërkojnë të bashkëpunojnë me AGS SH.A, prandaj përpara se operatorët ekonomikë të ofertojnë duhet të njihen dhe marrin përsipër t’i zbatojnë këto rregulla. Për më tepër, argumentojmë se këto rregulla nuk bien ndesh me rregullat e prokurimit publik, prandaj është vlerësuar nga ana jonë edhe vendosja e kriterit se operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë se do zbatojë rregullat e përcaktuara në Kodin e Etikës të AGS SHA që kanë lidhje me realizimin e objektit të kësaj kontrate.

II. Argumentimi i termave të referencës për të dyja lotet

Termat e Referencës janë hartuar nga grupi i punës përkatëse për të dyja lotet duke marrë në konsideratë detyrimet që rrjedhin nga nevojat e Autoritetit Kontraktor, për shërbimet objekt procedure prokurimi, natyrën e shërbimeve dhe afatin kohor për realizimin për të dy lotet e trajnimeve si dhe bazuar në nenin 36 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, në nenin 41/1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Termat e Referencës për të dyja lotet janë hartuar bazuar në nevojat konkrete të Autoritetit Kontraktor për ngritjen e kapaciteteve profesionale të personelit që ushtron detyra në fushën e sigurisë teknike, mbrojtjes nga atmosferat shpërthyesë dhe sistemeve të menaxhimit të cilësisë.

Përmbajtja e trajnimeve në termat e referencës është përcaktuar duke u mbështetur në kërkesat e legjislacionit në fuqi, standardet teknike ndërkombëtare dhe praktikat më të mira profesionale që

lidhen me menaxhimin e rreziqeve në ambiente me atmosferë potencialisht shpërthyes (ATEX), si dhe me zbatimin, auditimin dhe përmirësimin e sistemeve të menaxhimit të cilësisë.

Në hartimin e Termave të Referencës janë marrë në konsideratë standardet EN 60079, përfshirë kërkesat për klasifikimin e zonave, instalimin, inspektimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve në ambiente me rrezik shpërthimi, si dhe kërkesat e ISO 9001:2015 dhe udhëzimet e ISO 19011 për sistemet e menaxhimit dhe auditimin e tyre.

Gjithashtu, janë analizuar detyrat funksionale të personelit që do të trajnohet, niveli i njohurive të kërkuara, objektivat e institucionit dhe nevoja për përditësimin e njohurive në përputhje me zhvillimet më të fundit teknike dhe normative. Për këtë arsye, temat, kohëzgjatja, metodologjia dhe rezultatet e pritshme të trajnimit për të dyja lotet janë përcaktuar në mënyrë që të sigurojnë përfitim praktik dhe zbatim efektiv të njohurive në aktivitetin e përditshëm të institucionit.

Termat e Referencës e të dy loteve janë hartuar në përputhje me parimet e proporcionalitetit, transparencës dhe konkurrencës, duke përcaktuar kërkesa të nevojshme dhe të lidhura drejtpërdrejt me objektin e prokurimit.